

**FJALA E AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH NE FORUMIN
“EVROPA – MES MEJE DHE TEJE”, FIER**

2 mars 2012

Z. Velaj,
Të nderuar miq,
Zonja dhe zotërinj,

Ju falënderoj për mundësinë e dhënë që të flas para jush për këtë temë me interes dhe rëndësi për të gjithë qytetarët e Evropës.

Dhe më lejoni të shtoj se e bëj këtë duke ditur se është në kuadrin e një serie fjalimesh të filluar dy vite më parë, në shkurt 2010. Janë disa diplomatë të shquar që kanë mbajtur fjalën e tyre në këtë aktivitet që nga ajo kohë.

Më lejoni së pari të uroj z. Velaj për nderimin që i është bërë kohët e fundit duke u quajtur Qytetar i Evropës nga Parlamenti Evropian.

Ky çmim iu dha për arritjet e jashtëzakonshme për marrëdhëniet evropiane.

Unë mendoj se ka qenë ide e shkëlqyer t'ju zgjidhnin ju.

Ju lutem ta konsideroni këtë si një inkurajim për punën e mrekullueshme që po bëni.

Ishte kënaqësi për mua të pranoja ftesën tuaj.

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni të kthej vëmendjen tani te tema e ditës: *Evropa, mes meje dhe teje*.

Shumë prej jush e dini se para se të bëhesha Ambasadori i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, unë kam qenë diplomat karriere i Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë.

Për këtë arsye, për mua Evropa është njëkohësisht pasion dhe punë profesionale.

Kam punuar në fushën e çështjeve evropiane në Berlin dhe në Bruksel dhe në disa prej ambasadave tona, dhe tani kam kënaqësinë të punoj në mënyrë të ngjashme me OSBE-në në Tiranë.

Një person, një burrë, një grua nuk duhet të jetë domosdoshmërisht qytetar i Bashkimit Evropian për t'u ndjerë "Evropian" dhe për t'i qëndruar vlerave të Evropës moderne.

Në veçanti, Bashkimi Evropian, OSBE dhe Këshilli i Evropës përfaqësojnë çështjet thelbësore që po përmirësojnë dukshëm jetët tona në kohët moderne: të drejtat e njeriut, paqja dhe siguria, liria, shteti i së drejtës dhe prosperiteti – dhe këto janë vetëm çështjet më thelbësore.

Shumë shtete në Evropë, dhe kudo në botë, ndajnë të njëjtat synime të larta.

Këto synime mund të arrihen vetëm në krye të një procesi historik dhe civilizues.

Janë të vështira për t'u arritur dhe të pagarantuara për ato shoqëri që nuk janë ende gati për t'i mbrojtur këto vlera çdo ditë.

Duke qenë se jam Ambasadori i OSBE-së në Shqipëri, kam dëshirë të ndërmarrim një udhëtim të shkurtër bashkë përgjatë një përmbledhjeje të historisë së OSBE-së, strukturës së saj dhe asaj që përfaqëson, dhe jo më pak edhe në lidhje me aspiratat e vazhdueshme të integritetit të Shqipërisë.

Siç do ta shihni, ka lidhje të dukshme midis punës së Prezencës dhe atyre aktiviteteve që sjellin Shqipërinë më pranë strukturave të Bashkimit Evropian.

Ky udhëtim i shkurtër përgjatë historisë së OSBE-së do të përfshijë rritjen e OSBE-së nga fillimet e veta në Helsink drejt një organizate me shtrirje me të vërtetë globale e cila është angazhuar në mënyrë aktive në parandalimin, zgjidhjen, dhe në rehabilitimin pas konflikteve.

OSBE-ja është e angazhuar edhe në aktivitete të tjera në lidhje me sigurinë, bashkëpunimin, të drejtat e njeriut dhe më tej.

Këto hapa u hodhën gjatë kohës kur Lufta e Ftohtë ishte në kulmin e saj, dhe kur Shqipëria vuante nga shtypja komuniste nën drejtimin e Enver Hoxhës.

Historia e OSBE-së ka filluar me KSBE-në – të cilën do ta shpjegoj shkurtimisht.

Nënshkrimi i Aktit Final të Helsinkit në 1 gusht 1975 ishte një ngjarje historike.

35 Kryetarë Shtetesh – nga Perëndimi dhe Lindja – u angazhuan të kenë dialog reciprok përfitues sesa shkatërrim të sigurt reciprok.

Akti Final i Helsinkit ishte një marrëveshje historike në shumë aspekte.

Një nga më të rëndësishmet ishte fakti që e shndërroi çështjen e të drejtave të njeriut në një çështje ndërkombëtare.

Deri në atë kohë, ishte konsideruar si një fushë jo funksionale në marrëdhëniet midis Lindjes dhe Perëndimit.

Pas miratimit të Aktit Final të Helsinkit, shtetet nuk mund t'i fshihnin më shkeljet e të drejtave të njeriut nga syri vëzhgues i ndërkombëtarëve nën justifikimin se ishin çështje të brendshme.

Këtu u hodhën themelet e para të fillimit të përmirësimit të të drejtave dhe lirive ndërkombëtare të njeriut, duke përfshirë edhe vendet që deri në atë kohë kishin qenë të mbyllura për shkak të regjimit komunist.

Në marrëveshje përfshiheshin tre grupime parimesh, shpesh të njohura si 'shporta' ose 'dimensione'.

Ishin çështjet e lidhura me aspektet politiko-ushtarake të sigurisë (shporta I) – që shihen si çështje me prioritet të lartë; duke vijuar me çështjet ekonomike, shkencore, teknologjike dhe mjedisore (shporta II) – të përfshira me kërkesë të 'bllokut lindor' të asaj kohe; dhe çështjet humanitare dhe fushat e tjera (shporta III) – të përfshira nga Perëndimi.

Për më tepër se një dekadë e gjysmë pas nënshkrimit të Aktit Final të Helsinkit, Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE) shërbente si një forum dialogu dhe katalizator ndryshimi; duke formuar kështu një urë jetësore midis dy gjysmave të asaj që në atë kohë ishte ende një Evropë e ndarë ideologjikisht, politikisht dhe ekonomikisht.

Megjithatë, asnjë prej 35 nënshkruesve të fillimit nuk mund të kishte parashikuar shpejtësinë befasuese me të cilën u përmbys blloku komunist në fund të viteve '80.

Regjim pas regjimi filluan të rrëzoheshin si rezultat i lirisë që po lindte për t'iu kundërvënë mjerimit të plotë.

Më tej, ishte e lehtë të rrëmbeheshe nga atmosfera universale optimiste në dukje.

Megjithatë, historia shoqërohet nga një trashëgimi – dhe një pjesë e saj është helmuese.

Në Evropën Lindore u rishfaqën shumë tensione të vjetra etnike, politike dhe gjeografike.

Pavarësisht të gjithë përpjekjeve për t'i ndaluar, në vitet që pasuan lindën një sërë konfliktesh të përgjakshme.

Ishte e qartë që ai kuadër bashkëpunimi i siguar nga Helsinki nuk ishte më i mjaftueshëm.

Ndërsa Bashkimi Sovjetik kishte marrë rrugën e ndarjes, KSBE-ja po zhvillohej sipas kërkesave në ndryshim për të përballur sfidat në lidhje me sigurinë në Evropën e re.

Në nëntor 1990, Kryetarët e Shteteve ose Qeverive të KSBE-së u takuan në Paris në atë që ishte vetëm Samiti i dytë, për të hedhur bazat për transformimin e KSBE-së nga një Konferencë diplomatike në një Organizatë dedikuar mbrojtjes dhe bashkëpunimit në Evropë.

KSBE-ja krijoi shumë misione në terren dhe organizma të tjerë për të adresuar sfidat e reja të krijuara nga situatat tashmë të paqëndrueshme në shumë rajone të Evropës Lindore e përtej.

Ky proces u karakterizua nga riemërimi i KSBE-së në OSBE në Samitin e Katërt të Kryetarëve të Shteteve në Budapest në dhjetor 1994.

Në fund të viteve '90, OSBE-ja kishte krijuar një numër të gjerë operacionesh dhe misionesh në terren, duke variuar nga misione me një numër të vogël punonjësish në misione me mbi 1,000 punonjës si në rastin e Kosovës.

Me anë të metodave të tyre të punës, fleksibël dhe praktike, misionet në terren kontribuan gjerësisht në rritjen e sigurisë dhe stabilitetit në shumë pjesë të Evropës.

Megjithatë, mbërritja e mijëvjeçarit të ri – ende larg futjes në një epokë të re paqeje dhe sigurie – tregoi edhe një herë sa e vërtetë është thënia që çmimi i lirisë është vigjilenca e përrjetshme.

Ngjarjet e tmerrshme të 11 shtatorit dhe sulme të mëvonshme terroriste në shumë Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, treguan nevojën për një përqasje më të gjithëmbarshme ndaj sigurisë globale.

Ndërkohë, filluan të dëgjoreshin edhe zëra të tjerë për reformë të OSBE-së.

A ishte OSBE-ja, e cila kishte arritur aq shumë gjatë viteve '90, e pajisur për të zgjidhur sfidat e shekullit të 21-të?

Kjo është një pyetje që do të vazhdojë të diskutohet hollësisht ndërsa 56 Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së diskutojnë të ardhmen e saj.

Tani më lejoni t'ju prezantoj shkurtimisht strukturën e punës së OSBE-së:

Me 56 Shtete pjesëmarrëse nga Evropa, Azia Qendrore dhe Amerika e Veriut, OSBE-ja formon organizatën rajonale më të madhe për sigurinë në botë – që nga Vankuveri në Vladivostok.

OSBE-ja funksionon në bazë konsensusi.

Të gjitha vendimet brenda organizatës, vendimi se cili shtet do të ketë kryesinë e organizimit për një vit merret me konsensus nga të gjithë 56 shtetet pjesëmarrëse.

Kryesinë e radhës së OSBE-së për vitin 2012 e ka Irlanda.

Imagjinoni të drejtoni një organizatë ose një kompani bordi i të cilës përbëhet nga 56 anëtarë ku secili ka të drejtën e vetos.

OSBE-ja mund të ndalohet në çdo moment nga secili prej këtyre 56 anëtarëve.

Megjithatë, ata nuk e bëjnë këtë gjë.

Pse? – sepse kanë interes të mbajnë ritmin, të zbatojnë angazhimet për të cilat kanë rënë dakord dhe të kenë këtë lloj presioni të përhershëm nga njëri-tjetri.

Këshilli i Përhershëm mblidhet çdo të enjte dhe mund të dëgjojë fjalën e të ftuarve të posaçëm, të cilët adresojnë çështje aktuale, Ministra të Jashtëm, Kryetarë të Misioneve në Terren dhe institucione të tjera të OSBE-së.

Çështjet aktuale janë ato për të cilat ka interes të flasë çdo shtet anëtar në cilindo prej të tre dimensioneve.

Shpeshherë kjo ngre çështje të shumëllojshme dhe shumë interesante.

Në dhjetor të vitit 2009, Këshilli i Përhershëm miratoi Buxhetin e Organizatës për vitin 2010, që arrinte një shifër totale prej më shumë se 150 milion Euro.

OSBE-ja punëson rreth 450 persona në institucionet e ndryshme të saj dhe rreth 3, 000 persona në terren.

Ata janë shumë të ndryshëm.

Ata janë grupe ekspertësh që janë aty, në terren, dhe që kërkojnë ndihmën e vendit pritës në mënyrë që të ndihmojnë me zbatimin e standardeve dhe angazhimeve të OSBE-së.

Dhe nuk ka asnjë organizatë që është, asnjë prej këtyre zyrave në terren nuk është e njëjtë. Ato janë të gjitha produkt i një lloji "lidhjeje" midis vendit pritës dhe asaj që 56 shtetet janë të gatshme të ofrojnë në kuptimin e asistencës.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri u krijua në datën 7 mars 1997, si një përgjigje ndaj rënies së ligjit dhe rendit, me ftesë të Qeverisë Shqiptare dhe pas një vendimi të marrë nga Këshilli i Përhershëm.

Mandati i Prezencës u zgjat në dhjetor të vitit 2003 për të reflektuar progresin e përgjithshëm të arritur në Shqipëri gjatë viteve të fundit dhe rolin pozitiv që Shqipëria ka luajtur në përmirësimin e marrëdhënieve në Evropën Juglindore.

Atëherë, si tani, Prezenca punon në partneritet me Qeverinë dhe institucione të tjera kombëtare për të forcuar institucionet kryesore të shtetit, për të përforcuar një sistem demokratik të 'kontrollit dhe balancave' dhe për të nxitur dialogun ndërpartiak në mënyrë që të krijohet besim në këto institucione.

Prezenca fokusohet veçanërisht tek: reforma legjislativë dhe juridike; reforma për pronën; reforma administrative rajonale; reforma zgjedhore; rritja e kapaciteteve të Parlamentit; anti-trafikimi dhe anti-korrupsioni; hartimi i ligjeve dhe rregulloreve efikase për median e pavarur; promovimi i qeverisjes së mirë dhe menaxhimi i projekteve që synojnë forcimin e shoqërisë civile; dhe asistencë për policinë në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë.

Përveç zyrave qendrore të Prezencës në Tiranë, ne kemi mbështetjen e katër zyrave tona rajonale, në veri në Shkodër dhe Kukës, në jug në Vlorë dhe Gjirokastrë, që ndihmojnë me koordinimin e aktiviteteve të projekteve të Prezencës jashtë Tiranës dhe mbajnë kontaktet me aktorët kyçë vendorë.

Prezenca menaxhon një buxhet bazë prej rreth 3.2 milionë Euro me rreth 100 punonjës – prej të cilëve 75% janë punonjës shqiptarë.

Pika kryesore që duhet theksuar këtu është që mbështetja e Prezencës për Shqipërinë synon që të mbështesë procesin e vazhdueshëm të reformës për të ndihmuar vendin lidhur me aspiratat për integrim në Evropë.

Ne ofrojmë asistencë teknike për të forcuar kapacitetet e tyre dhe për të përgatitur ligje që janë të nevojshme për të këtë synim.

Gjithashtu, ne bashkëpunojmë ngushtësisht me Delegacionin e BE-së në Tiranë.

Një shenjë e kësaj është fakti që Prezenca e bazuar në mandatin tonë të OSBE-së po zbaton disa projekte kyç të cilët janë financuar nga BE-ja. Mund të përmend këtu projekti për asistencë teknike për Qeverinë për modernizimin e sistemit administrative të adresave dhe regjistrimit civil.

Së fundi, ne përiqemi gjithashtu që të asistojmë partnerët tanë politikë për të zgjidhur çështjet politike të ditës – edhe pse siç do ta vini re nga media, përpjekjet tona për të ndihmuar nuk janë perceptuar gjithmonë pozitivisht nga cilado palë.

Për ta mbyllur,

Për OSBE-në mesazhin thelbësor është ideja që siguria duhet të vijë në një mënyrë ndër-dimensionale, në mënyrë që të mund të ndërtojmë siguri të përgjithshme afatgjatë ndërmjet shteteve tona pjesëmarrëse bazuar në një sistem sigurie funksional.

Më lejoni që të theksoj, OSBE-ja si një organizatë për sigurinë merret jo vetëm me çështje të sigurisë ushtarake, çarmatimin apo çështjet për kufirin. Në fakt, OSBE-ja e konsideron sigurinë më shumë, shumë më shumë sesa mungesë të luftës. Vlera jonë unike është dimensionin njerëzor, të kuptuarit që nëse nuk ka respekt për të drejtat e njeriut dhe respekt për dinjitetin e individit dhe shtetin ligjor dhe një perspektivë demokratike, nuk mund të ndërtohet kurrë një siguri afatgjatë. Bazuar në këtë koncept të gjerë për sigurinë, një kuadër gjithëpërfshirës për paqen dhe stabilitetin në Evropë kërkon përkrahjen për të drejtat e njeriut dhe demokracinë.

Kjo fushë është gjithmonë në zhvillim, një fushë që pasqyron jo vetëm bashkëpunimin në rritje midis Shteteve të ndryshme, por gjithashtu edhe transformimin e shoqërive brenda këtyre Shteteve. Pra, ndërsa parimet e reflektuara në angazhimet e OSBE-së lidhur me këtë duhen parë në një kontekst historik dhe kanë përparuar, koncepti thelbësor i OSBE-së është vërtetuar se ka qenë më i vlefshëm se kurrë: një shoqëri e lirë që i lejon cilitdo që të marrë pjesë plotësisht në jetën publike është një mburojë kundër konfliktit dhe mungesës së stabilitetit. Përputhshmëria me këto parime të rëndësishme është konsideruar shpeshherë si një gur themeli për aplikimet për pranim të vendeve që dëshirojnë të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, OSBE-ja përiqet që të mbajë paqen duke u përfshirë në 'paralajmërimin e hershëm' dhe parandalimin e konfliktit në mënyrë që të mos krijohet një situatë ku një konflikt ka ndodhur ndërkohë. Në ato raste duhet angazhim për menaxhimin e krizave dhe rehabilitimin pas konfliktit, që do të thotë se dëmi ka ndodhur tashmë.

Pra, parimet kryesore të kësaj ambicieje janë kryesisht: përfshirja, barazia, konsensusi dhe bashkëpunimi.

Pra kjo është ajo që kisha në mendje që t'ju paraqisja si një prezantim të shkurtër të OSBE-së me një tablo të qartë të Evropës.

Dua t'ju inkurajoj që të futeni në më shumë detaje duke vizituar faqen tonë në internet www.osce.org/albania, ku ju mund të gjeni aktivitetet aktuale dhe ato të mbajtura në të shkuarën dhe dokumente themelore.

Zonja dhe Zotërinj,

Mund ta shihni që fillimi i OSBE-së i ngjan fillimeve të BE-së, kur Konrad Adenauer dhe Robert Schumann gjetën mirëkuptimin për të ndërtuar një urë mbi hendekun midis Gjermanisë dhe Francës pas shumë luftërash, në vitet 1950 shumë shpejt pas Luftës së Dytë Botërore.

“Montanunion”-i për qymyrin dhe çelikut e atyre ditëve është zhvilluar në një Bashkim të fuqishëm dhe të begatë, që disa e quajnë, përfshirë një lloj admirimi, “Festung Europa”.

Më lejoni që të kujtoj fjalët dhe vlerat e rëndësishme që përmenda në fillim të fjalimit tim, për të cilat qëndron kjo fortesë: "të drejtat e njeriut, liria, paqja dhe siguria, shteti ligjor dhe begati."

Zonja dhe Zotërinj,

Mendoj se e kam shprehur në mënyrë transparente që, për mendimin tim, OSBE-ja dhe BE-ja bazohen në të njëjtat vlera dhe punojnë për të njëjtin rezultat: për një botë Evropiane më të sigurt dhe më të mirë. Do të doja që të përfshija në këtë mendim edhe elementin e partneritetit të fortë transatlantik, i cili plotëson përpjekjet Evropiane të détente-s në të gjitha drejtime – Perëndim dhe Lindje, Lindje dhe Perëndim.

I uroj Shqipërisë progres të shpejtë në procesin e integrimit Evropian.

Do të ishte e mrekullueshme që të shihnim të bëheshin hapa vendimtarë ndërsa afrohet dita e 100-vjetorit të pavarësisë, këtë vit.

Ne jemi këtu si partnerë dhe miq të Shqipërisë.

Dhe ne jemi këtu për të ndihmuar.

Ju faleminderit shumë.